



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**“ISA BOLETINI”**

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës  
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it  
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1350/004  
Dt 04.10.2017

Senati i Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” në përputhje me Statutin në fuqi dhe Rregulloren për të ardhurat personale, në mbledhjen e mbajtur më 3.10.2017, në bazë të nevojave të njësisve akademike, mori:

**Vendim**

- I. Për shpalljen e konkursit për angazhimin me honorar të personelit akademik për vitin akademik 2017/2018.
- II. Angazhimi me honorar i personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat Statutit në fuqi dhe Rregullores për të ardhura personale të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”, Ligjit për arsimin e lartë dhe Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës nr. 03-L-212.
- III. Kushtet e përgjithshme për angazhim:
  1. Personeli akademik që aktualisht ka marrëdhënie të rregullt pune në Universitetin e Mitrovicës, personeli akademik nga pika 3 e vendimit të KD-së nr. prot. 443/0005, të datës 31.3.2017, si dhe personeli që ka pasur marrëdhënie të rregullt pune por që ka mbushur moshën e pensionimit dhe është nën moshën 70 vjeçare, nuk ka nevojë të konkurrojë për angazhim pasi që angazhimi i tyre do të bëhet në përputhje me kualifikimet dhe nevojën e njësisve akademike. Gjithashtu, edhe personeli akademik i Universitetit të Prishtinës, me thirrje adekuate akademike, dhe personeli akademik i universiteteve publike të Republikës së Shqipërisë, me thirrje adekuate akademike, nuk kanë nevojë të konkurrojnë pasi që angazhimi i tyre do të bëhet në pajtim me marrëveshjen për ndarje në mes të UMIB – it dhe UP – së, respektivisht marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura nga UMIB me universitetet publike të Republikës së Shqipërisë, për këmbimin e personelit akademik.
  2. Personeli i jashtëm akademik mund të angazhohet në UMIB për një periudhë të caktuar kohore, me qëllim të realizimit të veprimtarisë arsimore, shkencore dhe artistike, mbi bazën e një konkursi publik, për pagesë me honorar, si bashkëpunëtorë i jashtëm.
  3. UMIB gjatë përzgjedhjes së stafit për angazhim me honorar në mësimdhënie (ligjërata), në kushte të barabarta, përparësi do t’u japë kandidatëve që më parë kanë qenë të angazhuar në UMIB dhe të cilët kanë pasur performancë të kënaqshme.
  4. Personeli akademik që ka dy marrëdhënie pune, brenda apo jashtë Universitetit të Mitrovicës, (me pagë primare dhe sekondare) nuk mund të marrë me pagesë orë mbi normë në UMIB (ligjërata ose ushtrime).
  5. Kandidatët të cilët do të përzgjidhen për angazhim me honorar në mësimdhënie dhe ushtrime, do të pajisen me kontrata për honorar varësisht prej fondit të orëve që posedojnë. Angazhimi sipas këtij konkursi nuk nënkupton pagesë me automatizëm gjatë periudhës për të cilën angazhohet. Nënshkrimi i kontratave për angazhim me honorar do të bëhet vetëm pas konstatimit të normës së orëve dhe grupeve që do të formohen pas pranimit të studentëve. Kontrata do të bëhet veç e veç për secilin semestër të vitit akademik 2017/2018, duke përfshirë edhe obligimet, që dalin nga procesi mësimor (mbajtja e provimeve, etj.).

6. Kompensimi do të bëhet në përputhje me raportin e orëve të realizuara gjatë semestrit të caktuar, i cili vërtetohet nga njësia përkatëse akademike, por jo më shumë se fondi i orëve të përcaktuara sipas rregullores në fuqi për të ardhurat personale të të UMIB – it.
- IV. Pjesë e këtij vendimi është edhe konkursi për angazhimin me honorar të personelit akademik, i hartuar në bazë të nevojave të njësive akademike të UMIB-it.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakulteteve;
3. Prorektorit për mësimdhënie dhe kërkime shkencore;
4. Zyrës së personelit;
5. Zyrës ligjore.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it